



20

# RAPORTI VJETOR

24

# PROFILI I KOMPANISË

EUROSIG, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me dhjetëra degë e agjenci dhe rreth 200 pika shitjeje e përfaqësimi. Aktualisht, në Eurosig janë të punësuar qindra punonjës në nivel qendror dhe vendor.

Përkushtimi në shërbimet e sigurimit që ofrojmë ka sjellë rritjen e vazhdueshme të numrit të klientëve, të cilët na kanë besuar. Nga viti në vit, nën siglën “EUROSIG”, treguesit ekonomiko-financiare të shoqërisë kanë shënuar rritje 2-shifrore.



# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                   |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës .....                                                     | 4  |
| Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm .....                                                             | 6  |
| Struktura qeverisëse e shoqërisë .....                                                                            | 8  |
| Vizioni, misioni, vlerat e Eurosig .....                                                                          | 9  |
| Burimet njerëzore, veprimtaritë kryesore, klientët dhe partnerët e Eurosig .....                                  | 11 |
| Eurosig nëpërmjet shifrave .....                                                                                  | 17 |
| Disa të dhëna për Grupin Financiar Eurosig–Insig–UBA .....                                                        | 18 |
| Përgjegjësia sociale dhe promovimi i vlerave .....                                                                | 21 |
| Pjesëmarrjet e Eurosig në kapitalin e shoqërive të tjera .....                                                    | 34 |
| Lista e aksionarëve të Eurosig me pjesëmarrje influencuese të kapitalit .....                                     | 34 |
| Lista e administratorëve të Eurosig .....                                                                         | 34 |
| Opinion i shkurtuar mbi auditimin e brendshëm .....                                                               | 35 |
| Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr Eurosig .....                                         | 39 |
| Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, të likuiditetit dhe të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike ..... | 42 |
| Objektivat për vitin 2025 .....                                                                                   | 44 |
| Opinion i shoqërisë audituese dhe pasqyrat financiare të konsoliduara sipas SNRF .....                            | 46 |

# FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

**Vasil PILO**

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës



*Të nderuar lexues dhe aksionerë të Eurosig,*

Në emër të Këshillit Mbikëqyrës, unë dëshiroj të shpreh kënaqësinë tonë për rezultatet dhe progresin e arritur në vitin 2024, i cili konsiderohet një vit i suksesshëm në realizimin e objektivave dhe prioriteteve tona. Bazuar në planifikime të kujdesshme dhe drejtim strategjik vizionar, Grupi Financiar Eurosig-INSIG-UBA po performon me sukses në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, duke treguar qëndrueshmëri dhe standarde të larta.

Në themel të arritjeve tona, qëndron bashkëpunimi i suksesshëm ndër vite me klientët dhe partnerët tanë. Në udhëtimin tonë të përbashkët, kemi identifikuar vazhdimisht mundësi të reja, duke ecuar me kërkesat e tregut dhe përshtatur me nevojat e klientëve.

Në 20 vite veprimtari, Eurosig ka vepruar si biznes i motivuar shpirtërisht,

duke ndihmuar njerëzit të ndërtojnë një të ardhme më të sigurtë, duke u kujdesur për jetën dhe pasuritë e tyre, duke ofruar zgjidhje me kompetencë dhe qasje njerëzore.

Rritja e vijueshme vit pas viti, në nivel Shoqërie dhe si Grup Financiar, performanca, konsolidimi dhe stabiliteti brenda normave të lejuara i treguesve ekonomiko-financiar tregojnë se Shoqëria Eurosig është e shëndetshme dhe se sistemet e saj të kontrollit dhe ato operationale janë në gjendje të përballojnë volumin e një rritjeje konstante të biznesit. Ndër vite, Eurosig e mbështet rritjen e vet fitimprurëse mbi baza të shëndetshme financiare, duke rritur vlerën për aksionerët tanë, si dhe duke krijuar mundësi për karrierë dhe shpërblime financiare për punonjësit dhe agjentët, që na përfaqësojnë çdo ditë në mbarë vendin. Kjo shërben si garanci në realizimin me sukses të objektivave tona.

Rezultatet e arritura ndër vite janë shprehja më e mirë e leadershipit vizionar, drejtimit me integritet, vendimmarrjes së suksesshme dhe performancës në rritje të menaxherëve dhe stafeve respektive të subjekteve të Grupit. Punonjësit tanë besojnë në atë që bëjnë dhe punojnë gjithnjë e më shumë.

Në emër të Këshillit Mbikëqyrës, falënderoj përzemërsisht Drejtorin e Përgjithshëm, Menaxhmentin dhe të gjithë punonjësit e shoqërisë Eurosig për punën dhe arritjet në vite. Përkushtimi dhe angazhimi juaj vijues ndaj klientëve është garanci e suksesit tonë në të ardhmen.

Falënderim i veçantë për arritjet tona u takojnë aksionerëve, për mbështetjen e vazhdueshme; klientëve dhe partnerëve të biznesit, për besimin që na kanë dhënë ndër vite. Duke u mbështetur në rezultatet e arritura në këto dy dekada, në aftësitë, përkushtimin dhe pasionin e kolegëve dhe agjentëve tanë, me mbështetjen e vazhdueshme të aksionerëve, ne do vijojmë të shkruajmë së bashku faqe të tjera të rëndësishme në historinë e Eurosig.

Grupi Financiar Eurosig-INSIG-UBA do vazhdojë krijimin e vlerave të qëndrueshme për të gjitha palët e interesuara dhe do të jetë një partner i besueshëm për secilin prej klientëve tanë edhe në kohë sfiduese.



# FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



**Dr. Xhevdet KOPANI**  
Drejt看 i Përgjithshëm

*Të nderuar klientë, partnerë, miq e bashkëpunëtorë,  
Të nderuar punonjës të Grupit Eurosig-Insig-UBA,*

Në vijim të traditës së krijuar, i bashkohemi Raportit Vjetor 2024 për të shprehur konsideratat për një vit të suksesshëm, objektivat për vitin 2025, por mbi të gjitha dhe falënderimet për punën dhe kontributin e çdo njërit prej punonjësve të të gjitha niveleve të shoqërisë Eurosig sh.a.

Natyrisht, të gjithë ju jeni në dijeni të rezultateve të vitit 2024, nga të cilat dëshiroj të veçoj:

- ▶ Tregu i sigurimeve është karakterizuar nga zhvillime të qëndrueshme dhe me një rritje të moderuar, krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo rritje ka qenë më e madhe se rritja ekonomike e vendit, duke treguar se tregu financiar vazhdon të performojë mirë dhe qëndrueshëm dhe të tregoj jo vetëm stabilitet, por dhe rritje.
- ▶ Tregu u rrit me rreth 6.7%, çka përbën një rritje të pranueshme dhe solide edhe për të ardhmen.
- ▶ Rreth 8,4% më shumë klientë i besuan në vitin 2024 shoqërive të sigurimit, ose mbi 1,442,920 klientë kanë nënshkruar kontratat e sigurimit me shoqëritë siguruese.
- ▶ Tregu vazhdon të jetë i orientuar në sigurimet motorike të detyrueshme, të cilat zënë rreth 67.2%, kundrejt 32.8% që zënë sigurimet vullnetare.
- ▶ Shoqëria Eurosig pati një rritje të primeve të shkruara bruto prej 7.6%, ose rreth 1% më shumë se rritja e tregut të sigurimeve.

▶ Një drejtim i rëndësishëm, që ka patur vëmendjen e shoqërisë Eurosig, është pagesa e dëmeve. Vlerësimi i klientëve është boshti kryesor, ku mbështetet suksesi i shoqërisë tonë të sigurimit. Natyrisht, kjo dëshmohet me vlerësimin e drejtë dhe pagesën në kohë të dëmeve. Rreth 36.6% më shumë klientë janë dëmshpërblyer në vitin 2024, ose rreth 46.6% në vlerë dëme të paguara më shumë se në vitin 2023. Duhet theksuar se volumi i dëmeve të paguara për tregun është rritur me 24.9%, nga 46.6% që është rritur ky tregues për Eurosigun.

▶ Shoqëria Eurosig, megjithëse fokusin kryesor ka patur pagesën e dëmeve të të siguruarve, një vlerësim po kaq të madh ka patur dhe ndaj dëmeve të Fondit të Kompensimit për kategoritë e të pasiguarve, ku këto pagesa janë rritur me rreth 17.7 %, duke qenë shoqëria me pagesat më të larta në tregun e sigurimeve.

▶ Zhvillimet në fushën digjitale, përafrimi i standardeve të sigurimeve në Eurosig me parimet dhe standardet e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) kanë qenë në themel të punës së shoqërisë tonë.

Shoqëria Eurosig sh.a., falë menaxhimit të mirë, mbikëqyrjes me fokus riskun nga AMF dhe bashkëpunimit me partner sigurues dhe risigurues të klasifikuar në nivelet më të larta, është e mirëkapitalizuar dhe konkurruese në treg.

Nisur nga ecuria e këtyre viteve, por dhe parashikimet optimiste të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare për zhvillimin e Shqipërisë, mendojmë që viti 2025 do të shënojë tregues pozitiv krahasuar me vitin 2024, pra kalojmë nga faza e qëndrueshmërisë në atë të rritjes dhe zhvillimit të tregut të sigurimeve në tërësi.

Parë në këtë këndvështrim, disa nga sfidat e shoqërisë së sigurimeve Eurosig për vitin 2025 do të jenë:

- ▶ Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe në këtë kuadër digjitalizimi i këtij shërbimi që, krahas shërbimit online në shitjen e produkteve të sigurimeve, të ofrojmë edhe shërbime të trajtimit të dëmeve në mënyrë digjitale, duke përmirësuar në këtë mënyrë shërbimin ndaj klientit, ofrimin e tij në kohë reale me të njëjtën ose me kosto të reduktuar dhe, mbi të gjitha, duke minimizuar kohën jo produktive të klientëve.
- ▶ Rritja e edukimit dhe promovimi i produkteve vullnetare ekzistuese dhe të reja mbetet sfida kyesore e shoqërisë Eurosig sh.a. Në këtë drejtim duhet punuar për sigurimin e katastrofeve natyrore, sigurimet në bujqësi, sigurimet në turizëm etj.

Duke falënderuar çdo punonjës/agjent/ndërmjetës në të gjithë Shqipërinë, si dhe të gjithë bashkëpunëtorët, menaxherët, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e Komiteteve, por veçanërisht Presidentin e Grupit Eurosig-INSIG-UBA, Z. Kadri MORINAJ, për mbështetjen dhe bashkëpunimin, shpreh bindjen e plotë se objektivat strategjike të shoqërisë për vitin 2025 do të realizohen.



# STRUKTURA QEVERISËSE E SHOQËRISË

Në Eurosig kemi implementuar praktikat më të mira të qeverisjes korporative, duke ndarë të drejtat dhe përgjegjësitë ndërmjet Asamblesë së Aksionarëve, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorit të Përgjithshëm, Menaxhimit të Lartë, Menaxhimit Operacional dhe Funksioneve Kryesore të Kontrollit. Në funksion të mirëqeverisjes, janë krijuar dhe funksionojnë edhe Komiteti i Auditimit&Menaxhimit të Riskut, Komiteti për Pajtueshmërinë, Komiteti për Sigurinë Kibernetike dhe Vazhdimësinë e Biznesit, Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit, Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve, Njësia e Kontrollit të Brendshëm, Ekipi për Mbrojtjen e të Dhënave Perso-

nale, Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Fushat e përgjegjësisë të organeve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale, të komiteteve dhe funksioneve kyçe të kontrollit janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Eurosig. Kjo ndikon pozitivisht në mënyrën e përcaktimit të strategjive dhe objektivave të Eurosig, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e personelit, kryerjen e veprimtarive ditore, respektimin e Kodit të Sjelljes dhe Etikës, duke operuar në pajtueshmëri me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi.



**Në Eurosig kemi implementuar praktikat më të mira të qeverisjes korporative**



**Eurosig ka konsoliduar pozicionin e saj duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë**

## VIZIONI, MISIONI, VLERAT E EUROSIG

### Vizioni

Të qenit lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohet nga performanca e shtuar, në përputhje me kërkesat e palëve të interesu-

ara, duke u mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimit tek ai.

### Misioni

#### Misioni i Eurosig është:

a) të sigurojë produkte, shërbime dhe aktivitete ndaj klientëve, nëpërmjet përsosjes së shërbimit, cilësisë, profesionalizmit, etikës, duke funksionuar si një shoqëri financiare, me qëllim optimizimin e kërkesave të klientëve, rritjen e kapitalit financiar, rritjen e vlerës së aksioneve, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, për kompensim

të plotë dhe të drejtë për dëmet e mundshme;

b) të ofrojë shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin e saj dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë;

c) të marrë reagime (feedback) nga klientët me forma e metoda bashkëkohore dhe reflektim të tyre, për të përmirësuar shërbimin.





Filozofia jonë në orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe të ardhmen



## Vlerat e Eurosig

Shoqëria Eurosig përbën një vlerë të shtuar në industrinë e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon. Përvoja 20 vjeçare në fushën e sigurimeve, zgjerimi i veprimtarive edhe në fusha të tjera financiare, i ka konsoliduar këto vlera, duke i bërë të qëndrueshme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet e shoqërisë dhe të Grupit.

Filozofia e Eurosigut për orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe të ardhmen. Ne kemi krijuar marrëdhënie afatgjata besimi me punonjësit, klientët, grupet e interesit duke iu përgjigjur kërkesave të tyre në kohë dhe me profesionalizëm. Në Eurosig punohet në grup, nxitet di-

versiteti, vlerësohen përpjekjet dhe puna orientohet drejt rezultatit.

Kontribut i çmuar i Eurosigut ndër vite është edhe përfshirja sociale, falë rolit të spikatur dhe vlerave altruiste të Presidentit të Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, z. Kadri Morinaj.

Performimi i Eurosig në raport me industrinë e sigurimeve dhe historinë e saj në treg, rritja, zgjerimi dhe konsolidimi në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, zgjerimi i veprimtarisë financiare të Grupit edhe në tregun bankar, të mikrokredive dhe të investimeve përbëjnë një vlerë me ndikim pozitiv në performancën tonë në të ardhmen.

# BURIMET NJERËZORE, VEPRIMTARITË KRYESORE, KLIENTËT DHE PARTNERËT E EUROSIG

## Burimet njerëzore

Eurosig, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me 22 degë, 6 agjenci dhe 203 punonjës në nivel qendror dhe vendor. Duke i konsideruar burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë, ne investojmë sistematikisht në përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e punonjësve.

Gjatë vitit 2024, standardi dhe performanca e burimeve njerëzore kanë shfaqur një përmirësim të qëndrueshëm dhe të matshëm. Proceset e rekrutimit dhe seleksionimit janë zhvilluar me efikasitet dhe transparencë, duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm për pozicionet e hapura. Trajnimet dhe zhvillimi profesional janë fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të stafit, duke

rritur motivimin dhe përkushtimin ndaj objektivave të shoqërisë. Menaxhimi i performancës ka qenë në përputhje me standardet e paracaktuara, me vlerësime të rregullta dhe një qasje proaktive ndaj zgjidhjes së sfidave që kanë lindur.

Shtrirja e Eurosigut në të gjithë vendin, burimet njerëzore profesionale dhe me integritet, aftësitë e larta të organeve qeverisëse përbëjnë garanci për sukses dhe përballim të sfidave në të ardhmen.





## Veprimtaritë kryesore të Eurosig

Shoqëria Eurosig ruan sandardet më të mira të produkteve të sigurimit, në përputhje me kërkesat e klientëve. Produktet tona janë hartuar duke u bazuar në produktet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit. Eurosig gëzon të gjithë ekspertizën e nevojshme dhe ofron asistencë dhe praktikën më të mirë në procesin e trajtimit të dëmeve.

Eurosig ushtron veprimtari sigurimi në përputhje me klasat, për të cilat është licencuar nga AMF. Linjat kryesore të biznesit të Eurosig përfshijnë veprimtaritë për sigurimin dhe risigurimin, për trajtimin e dëmeve, për çështjet ekonomiko-financiare, për pajtueshmërinë dhe çështjet ligjore, për teknologjinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike, për kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e risikut etj.

Veprimtari kryesore e Eurosig është realizimi i procesit të shitjes dhe marrjes në sigurim:

### ■ për produktet e sigurimeve

**vullnetare:** Sigurimi i Aksidenteve Personale, Sigurimi i Shëndetit dhe Sëmundjeve, Sigurimi Kas-ko, Sigurimi i Pasurisë (nga zjarri dhe forcat e natyrës), Sigurimet ndaj Dëmtimeve dhe Humbjeve të Tjera të Pasurisë, Sigurimi i Garancive të Ofertave dhe të Kontratave, Sigurimi i Mallrave në Transport, Sigurimi i Përgjegjësisë të Anijeve dhe Mjeteve Lundruese, Sigurimi i Përgjegjësisë (profesionale/publike/të punëdhënësit), Sigurimi i Bankave BBB&ECC etj.;

### ■ për produktet e sigurimit të de-

**tyrueshëm:** Sigurimi i Detyrueshëm Motorik për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta (DMTPL), Certifikata Motorike Ndërkombëtare e Sigurimit (Kartoni Jeshil), Sigurimet Kufitare etj.

Veprimtaritë e linjave të biznesit mbështeten nga një sistem dhe rrjet informatik bashkëkohor.

”  
Eurosig  
ofron asistencë  
dhe praktikën më  
të mirë në procesin  
e trajtimit të dëmeve



## KLIENTËT E EUROSIG

Filozofia e Eurosig është e orientuar ndaj klientëve, duke realizuar krijimin e një partneriteti afatgjatë me klientët tanë. Si rezultat i besimit të krijuar ndër vite, sot ne numërojmë mes klientëve tanë shoqëri dhe institucione të rëndësishme për vendin, si banka dhe institucione financiare, si dhe kompani të mëdha biznesi, për të cilat shërbimi është ofruar i personalizuar dhe në kohë reale. Synimi jonë është të ofrojmë zgjidhje praktike dhe të shpejta për kërkesat e klientëve tanë, si dhe përgjigje në kohë dhe në masë e dëmshpërblimeve, në rast dëmi. Për këtë, stafi i mirëtrajnuar dhe me aftësi të shkëlqyera teknike dhe komunikimi përcjell të njëjtën filozofi biznesi tek klientët.







**Me partnerët kemi krijuar një fleksibilitet dhe cilësi të veçantë shërbimi ndaj klientëve**



## Partnerët e Eurosigg

Shoqëritë e sigurimeve përballen me rrezik të madh financiar kur ndodhin ngjarje të mëdha apo katastrofike (si tërmete, përmytje, aksidente industriale etj.). Detyrimet financiare ndaj klientëve tanë garantohen jo vetëm nga kapacitetet tona teknike dhe financiare, por dhe nga tregu financiar ndërkombëtar. Pjesëmarrësit në kontratat e risigurimit që lidh Eurosigg janë shoqëri risigurimi që përmbushin standardet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve dhe stabilitetit financiar, të listuara në bazën e vlerësimeve ndërkombëtare, në pajtueshmëri dhe në zbatim të kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, rregullatore dhe në aktet e brendshme të Eurosigg.

Shoqëria Eurosigg ka investuar një kosto të rëndësishme për risigurimet me kompani risigurimi prestigjioze, si Hannover Re, Generali Group, Scor, VIG Re etj. për të garantuar financiarisht detyrimet e mundshme dhe përgjegjësitë ndaj klientëve, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Grupi Eurosigg ka ruajtur prej disa vitesh dhe ka zgjeruar bashkëpunimin edhe me risigures të tjerë, si Munich Re, Sava Re dhe Swiss Re. Ne, gjithashtu, zhvillojmë marrëdhënie bashkëpunimi për risqet fakultative edhe me kompani të tjera risigures, duke u mbështetur në kriterin e vlerësimit financiar si dhe standardin e bashkëpunimit.

Marrëveshjet e Risigurimit të Pronës dhe Përgjegjësi si dhe Sigurimit të Detyrueshëm për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (TPL, Sigurimi Kufitar dhe Karton Jeshil), përveç garancisë financiare në pagesat e dëmeve të mëdha, kanë krijuar një fleksibilitet dhe cilësi të veçantë shërbimi ndaj klientëve. Eurosigg bashkëpunon me MARSH & Guy Carpenter, AON, AJ Gallagher etj., vlerësuar në top 5 brokerat më të fuqishëm në tregun ndërkombëtar të risigurimeve. Ne kemi bashkëpunim edhe me Butcher Robinson, "GrECo International AG" etj.

## Vlerësime për partnerët e EUROSIG HANNOVER RE

Agjencitë e vlerësimit më të rëndësishme në industrinë e sigurimeve i kanë dhënë kompanisë së sigurimeve Hannover Re vlerësime shumë të forta për fuqinë financiare. I renditur si Risiguresi i tretë më i fuqishëm në botë, Hannover Re është një nga liderët Global në industrinë e risigurimit për vitin 2024. E themeluar më 1966 dhe me një staf prej më shumë se 3 000 punonjës, kjo kompani kryen aktivitet në të gjitha linjat e Risigurimit të Jo-Jetës, Jetës dhe Shëndetit, nëpërmjet më shumë se 170 degëve/agjencie/zyrave të përfaqësimit duke qenë e pranishme në të gjitha kontinentet.

| Vlerësimi: | Rating Agency | Rating | Outlook     |
|------------|---------------|--------|-------------|
|            | A.M. Best     | A+     | Superior    |
|            | S&P           | AA-    | Very strong |

Hannover Re ka ruajtur një pozicion të fortë financiar dhe ka marrë vlerësime të larta nga agjencitë kryesore të vlerësimit, gjatë vitit 2024.

## GENERALI GROUP

Generali Group është një nga aktorët më të rëndësishëm në tregun e sigurimit global dhe financiar, pasi është një nga grupet më të mëdha të sigurimeve në botë; duke marrë vlerësime të larta nga disa prej agjencie kryesore të vlerësimit të Fuqisë Financiare të Siguruesit (IFS). E themeluar që në vitin 1831, në Trieste, karakterizohet që nga fillimi me një opinion të fortë ndërkombëtar dhe tani është e pranishme në më shumë se 50 vende të botës nëpërmjet 500 kompanive ndërkombëtare. Me afro 82 000 punonjës dhe 164 mijë agjentë, që u shërbejnë 70 milionë klientëve, Generali Group klasifikohet në listën e 20 risigureseve më të mëdhenj në botë. Vlerësimi:

| Vlerësimi: | Rating Agency | Rating | Outlook |
|------------|---------------|--------|---------|
|            | A.M. Best     | A+     | Stable  |
|            | Fitch         | A+     | Stable  |
|            | Moody's       | A3     | Stable  |

Këto vlerësime pozitive dhe performanca e fortë financiare e vendosin Grupin Generali në një pozicion të favorshëm për të ofruar siguri dhe besueshmëri për klientët dhe investitorët e tij. Shoqëria Eurosigg bashkëpunon edhe me shoqëri të tjera Risigurimi, të vlerësuar si të sigurta dhe stabël në tregun ndërkombëtar, si:

| Risigures                                                  | Rating (S&P/AM Best) |
|------------------------------------------------------------|----------------------|
| DEVK Rückversicherungs-und Beteiligungs-Aktiengesellschaft | A+ / NR              |
| Deutsche Rückversicherung                                  | A+ / NR              |
| Helvetia                                                   | A+ / NR              |
| Munich Reinsurance Company                                 | AA- / A+             |
| Taiping Reinsurance Company Limited                        | A / A                |
| Toa Reinsurance Company, Limited                           | A / A                |
| VIG RE Zajistovna a.s.                                     | A+ / NR              |



## TRAJTIMI I ANKESAVE

Sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatore, bazuar në politikat dhe procedurat standarde të shoqërisë, në mënyrë të posaçme në Rregulloren "Për Procedurat dhe Shqyrtimin e Ankesave në Shoqërinë Eurosig sh.a.", shoqëria Eurosig trajton me seriozitet dhe përgjegjshmëri çdo ankesë që i drejtohet. Shoqëria mban regjistrin e ankesave, ku evidenton rastet, arsyet, por edhe zgjidhjen respektive për çdo rast. Informacioni raportohet edhe në AMF, mbi baza 6-mujore dhe vjetore. Për vitin 2024, objekti i ankesave më së shumti ka qenë i lidhur me procesin e trajtimit të dëmeve (nga aksidente automobilistike dhe, kryesisht, për dëme materiale) si: mospranim vlere/kërkesë për rivlerësim, vonesë në pagesë, vonesë në trajtim. Në të gjitha rastet, janë marrë masa për adresimin e tyre dhe për të dhënë zgjidhje sipas ligjit. Strukturat e Eurosig, veçanërisht ato të Trajtitimit të Dëmeve, janë të angazhuara maksimalisht, me profesionalizëm, për trajtimin dhe vlerësimin sa më real të dëmeve, me qëllim adresimin dhe uljen e numrit të ankesave.

## EUROSIG NËPËRMJET SHIFRAVE

Viti 2024 ishte i suksesshëm në realizimin e objektivave strategjike dhe prioriteteve tona. Disa nga treguesit kryesorë të vitit 2024, krahasuar me vitin 2023, janë:

▶ Volumi i primeve të shkruara bruto është 3,094,289,000 lekë, duke u rritur me 7.61%.

▶ Volumi i dëmeve të paguara është 800,297,000 lekë, me një rritje prej 46.64%.

▶ Volumi i sigurimeve vullnetare kundrejt totalit është 20.09%, 0.12 pikë përqindje më shumë.

▶ Për treguesin e volumit të primeve të shkruara bruto:

- o në Sigurimin Motorik kemi rritje me 8.47%, zotërojmë 15.53% të tregut, renditemi në vendin e tretë;
- o në produktet MTPL e Brendshme kemi rritje me 9.26%, zotërojmë 15.25% të tregut, renditemi në vendin e dytë;
- o në Sigurimin Kartoni Jeshil kemi rritje me 3.40%, zotërojmë 24.82% të tregut, renditemi në vendin e dytë;
- o në Sigurimin Kufitare zotërojmë 14.80% të tregut, renditemi në vendin e tretë;
- o në Sigurimin Kasko zotërojmë 7.93% të tregut, ren-

ditemi në vendin e 4-rt;

- o në Sigurimin Zjarri, Forcat e Natyrës & Dëmtimet e Tjera në Pronë kemi rritje me 36.91%;

- o në Sigurimin e Sëmundjeve kemi rritje me 16%, renditemi në vendin e katërt;

- o në Sigurimin e Garancive kemi rritje me 56.30%, renditemi në vendin e katërt;

▶ Volumi i dëmeve të paguara:

- o në Sigurimin Motorik është 1,083,606,000 lekë, me një rritje prej 71.15%;

- o në Sigurimin MTPL e Brendshme është 697,426,000 lekë, me një rritje prej 58.85%;

- o në Sigurimin Kartoni Jeshil është 293,067,000 lekë, me një rritje prej 169.50%;

- o në Sigurimin Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e Tjera në Pronë është 40,567,000 lekë, me një rënie me 60.78%;

- o nga Fondi i Kompensimit është 62,866,000 lekë, me një rritje prej 17.66%, renditemi në vendin e parë;

- o si sigurues i drejtëpërdrejtë është 18,224,000 lekë, me 71.91% rritje.

**2024 ishte një vit  
i suksesshëm në  
realizimin e objektivave  
tona strategjike**



# DISA TË DHËNA PËR GRUPIN FINANCIAR EUROSIG-INSIG-UBA

## Organizimi dhe funksionimi i Grupit Financiar Eurosrig-Insig-UBA

Sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore, Grupi Financiar Eurosrig-Insig-UBA funksionon i përbërë nga: shoqëria Eurosrig sh.a, shoqëri mëmë; shoqëritë Insig sh.a, Insig Jetë sh.a, Eurosrig sh.a Kosovë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Eurosrig-Invest sh.a. dhe

Eurosrig-MicroCredit sh.p.k., si shoqëri të kontrolluara.

Shoqëritë e Grupit gëzojnë parametrat e gjendjes financiare për vitin 2023 në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.



## Lloji i veprimtarisë së subjekteve të Grupit dhe totali i aktiveve më 31 dhjetor 2024

- ✦ Eurosrig sh.a. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jo-Jetë: Aktivitet totale 13,980,905,771 Lekë.
- ✦ Insig sh.a. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jo-Jetë: Aktivitet totale 5,404,381,245 Lekë.
- ✦ Insig Jetë sh.a. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jetë: Aktivitet totale 1,502,071,206 Lekë.
- ✦ Eurosrig sh.a. Kosovë, e licencuar për veprimtarinë e sigurimit Jo-Jetë: Aktivitet totale 28,517,171 Euro.
- ✦ Banka e Bashkuar e Shqipërisë, e licencuar për veprimtarinë bankare: Aktivitet totale 25,107,856,909 Lekë.
- ✦ Euro-Credit sh.p.k. Shqipëri, e licencuar për veprimtarinë e faktoring dhe kredidhënies: Aktivitet totale 420,412,131 Lekë.
- ✦ Eurosrig-Invest sh.a. Shqipëri, në proces licencimi: Aktivitet totale 24,962,440 Lekë.
- ✦ Aktivitet totale të Grupit Financiar Eurosrig – INSIG – UBA, më 31 dhjetor 2024, janë sipas Pasqyrës së Konsoliduar të Aktiveve të Grupit, bazuar në pasqyrat financiare individuale të certifikuara të të gjitha shoqërive.





### Treguesit kryesorë të shoqërive të sigurimit të Grupit për vitin 2024 (në Lekë)

| EMËRTIMI               | VOLUMI I PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO | PESHA SPECIFIKE NDAJ TOTALIT | DËME TË PAGUARA BRUTO        |
|------------------------|------------------------------------|------------------------------|------------------------------|
| EUROSIG SHQIPËRI       | 3,094,289,261                      | 44.24%                       | 1,251,660,080                |
| EUROSIG KOSOVË         | 1,927,807,474 (19,278,075 euro)    | 27.56%                       | 914,625,171 (9,146,253 euro) |
| INSIG JO-JETË SHQIPËRI | 1,556,618,268                      | 22.26%                       | 574,130,218                  |
| INSIG JETË SHQIPËRI    | 415,155,997                        | 5.94%                        | 57,168,531                   |
| TOTALI                 | 6,993,871,000                      | 100%                         | 2,797,584,000                |

- ✦ Kraheluar me vitin 2023, kemi rritje: Eurosig-KS sh.a. me 12.75%, Insig-Al sh.a. me 7.76%, Eurosig-Al sh.a. me 7.61% dhe Insig-Al Jetë sh.a. me 2.80%.
- ✦ Në Republikën e Shqipërisë:
  - o Eurosig dhe Insig së bashku zotërojnë 20.74% të tregut të Sigurimit të Jo-Jetës, duke u renditur në vendin e dytë, dhe 24.09% të tregut në Sigurimin Motorik, duke u renditur në vendin e parë;
  - o Insig Jetë zotëron 20.05% të tregut të Sigurimit të Jetës, duke u renditur në vendin e tretë.
- ✦ Në Republikën e Kosovës, Eurosig-KS zotëron 12.03% të tregut të jo-jetës, duke u renditur në vendin e tretë.

### PËRGJEGJËSIA SOCIALE DHE PROMOVIMI I VLERAVE

Përgjegjësia sociale është një vlerë e shtuar e Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, Z. Kadri MORINAJ, subjektet e Grupit janë të angazhuara për të maksimizuar ndikimin pozitiv në shoqëri dhe mjedisin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Një vëmendje të veçantë Grupi Eurosig-INSIG-UBA dhe Presidenti MORINAJ kanë ndaj mjedisit kulturor, artistik, mediatik, ndaj shtresave në nevojë etj.





**Përgjegjësia sociale është një vlerë e shtuar e Grupit Financiar Eurosigr-Insigr-UBA**



## **Veprimtaritë kryesore në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe promovimit të vlerave të Grupit Eurosigr-INSIG-UBA janë:**

- ✦ Grupi Eurosigr-Insigr-UBA mbështeti eventin në nderim të 100 vjetorit të artistit të madh “Nderi i Kombit”, zotit Kadri ROSHI. Në këtë event, nëpërmjet një dokumentari, u kujtua mjeshtri i skenës dhe kinematografisë shqiptare, duke sjellë ndërmend veprën e tij artistike si monument kulture. Gjithashtu, Grupi Eurosigr mbështeti edhe promovimin e librit “Në jetët e të tjerëve”, ku personalitete të artit, medias dhe politikës shqiptare kanë ndarë në libër kujtimet e tyre me Kadri Roshin. Në praninë e shumë personaliteteve në këtë event, Grupi Eurosigr mori falënderime të ngrohta për mbështetjen e vazhdueshme.
- ✦ Edhe pse në ditë të ftohta të dimrit, teatri shëtitës për fëmijë vijoi shfaqjet në shumë qytete të vendit. Mbështetur nga Grupi Eurosigr-Insigr-UBA, ndalesat e rradhës ishin në Pukë, Fushë Arrëz dhe Librazhd, ku për fëmijët u dha shfaqja “Fuqia e dëshirave”. Teatri shëtitës për fëmijë do vijojë të japë shfaqje edhe në qytete të tjera.
- ✦ Në ceremoninë e shpalljes “Qytetar Nderi” i qytetit të Durrësit të aktorit të madh Xhevdet Ferri, ishte i ftuar edhe Presidenti i Grupit Eurosigr-Insigr-UBA, Z. Kadri Morinaj. Në fjalimin e tij, në nderim të një prej ikonave të kinematografisë shqiptare, Z. Morinaj evidentoi se “figura kaq të shquara, si aktori Xhevdet Ferri, kanë lënë gjurmë në memorien tonë”. Grupi Eurosigr-Insigr-UBA mundësoi financiarisht edhe organizimin e Festivalit të

Filmit në qytetin bregdetar të Durrësit. Presidenti i Grupit, Z. Morinaj, në një takim me Kryetaren e Bashkisë Durrës, Zj. Emiriana Sako, u tregua i gatshëm për të mbështetur edhe projekte të tjera në këtë qytet të mrekulueshëm.

- ✦ Si çdo vit, edhe këtë 16 Mars, Vespa Club Tirana organizoi ditën e motoçikletave ikonike Vespa. Ky event shumë i këndshëm mbledhi fansa të Vespa nga vendet e rajonit dhe më gjerë. Grupi Eurosigr-Insigr-UBA ju bashkua paradës me Vespa 946 Christian Dior, unike dhe e vetmja në Shqipëri. Grupi Eurosigr-Insigr-UBA akordoi një ndihmë finaciare për të mundësuar zhvillimin e disa eventeve në këtë ditë, të cilat nisën me parada në rrugët e Tiranës dhe u përmbyllën me një koncert nën tingujt e këngëtares Juliana Pasha.
- ✦ Duke sjellë në skenë një komedi shumë të bukur të titulluar “Zonja e Butjtinës”, të autorit italian Carlo Goldoni, me regjinë e Suela Bakos dhe nën kujdesin e mësueses Orilda Kalami, nxënësit jo vetëm shijuan aventurat e personazheve dhe ngjarjeve në teatër, por zhvilluan dhe aftësitë e tyre krijuese. Grupi Eurosigr-Insigr-UBA, me mbështetjen e dhënë për realizimin e kësaj shfaqjeje, i frymëzoi këta të rinj të shijojnë fuqinë e artit të teatrit për të motivuar imagjinatën, miqësinë dhe guximin e tyre.
- ✦ Klubi i basketbollit Trepça, me sponsor zyrtar Eurosigr, u shpall kampion në kampionatin e Ligës Unike të zhvilluar në Vlorë. Mbështetja e Eurosigr për kampionët e Kosovës do të vijojë në kompeticionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.



**Eurosigr, sërish sponsor zyrtar i kampionëve të Basketbollit, Klubit Trepça**



- ✦ Qindra pako me ushqime u shpërndanë në muajn e shenjtë të Ramazanit nga Grupi Eurosig-Insig-UBA dhe Alesia sh.p.k. në Kukës, Pukë, Has dhe Fushë Arrëz. Grupi Eurosig dhe Alesia sh.p.k. u erdhën në ndihmë me ushqime shumë familjeve në vështirësi ekonomike, duke mos bërë dallime sipas besimeve fetare, por sipas pamundësive ekonomike. Urojmë mirëqenie për të gjithë shqiptarët dhe agjërime të pranuar për besimtarët myslimanë.
- ✦ Olen Cesari, violinist i jashtëzakonshëm me famë botërore, organizoi tre ditë koncert gjigand në Shqipëri. I shoqëruar nga Internacional Clandestinë Orhestra, së bashku me Sergio Cammariere, Marsela Çibukaj, Carlos Paz dhe Gaz Paja, violinisti i njohur u kthye pas dy vitesh në Tiranë për t'ju dhuruar artëdashësve disa netë të paharrueshme në Pallatin e Kongreseve. Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti këtë koncert, me qëllim që artistët të motivohen dhe qytetarët shqiptarë të shijojnë magjinë e artit në fillim verën 2024.
- ✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA ishte pjesë e Panairit të Karrierës me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Tiranës, një ndër fakultetet më prestigjioze në vend. Në kuadër të këtij aktiviteti u mbajt edhe një Tryezë e Rrumbullakët me përfaqësues të biznesit, të botës akademike dhe të pushtetit, ku u diskutua mbi problematikat e tregut të punës në Shqipëri. Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, shprehu shqetësimet lidhur me çështjet e punësimit, ku ndër të tjera u bëri thirrje të rinjve shqiptarë që të rrinë dhe të punojnë në Shqipëri, pasi ata mund ta zhvillojnë këtë vend. Interesi i studentëve për të qenë pjesë e kompanive të Grupit tonë ishte shumë i lartë. Atyre iu ofrua mundësia për t'u promovuar, intervistuar dhe vlerësuar. Shumë prej tyre aplikuan për t'u bërë pjesë e familjes tonë.

”  
Mbështetje  
për koncertin e  
paharrueshëm të  
Olen Cesarit, në fillim  
verën e 2024



- ✦ Grupi Eurosig-Insig mori pjesë në Panairin e Karrierës me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të Universitetit Western Balkans, një ndër universitetet më prestigjioze në vend. Nisur nga interesi dhe dëshira e lartë e studentëve, atyre iu ofrua mundësia për të qenë pjesë e shoqërive Eurosig dhe Insig.
- ✦ Pranë Akademisë së Shkencave, u zhvillua promovimi i librit “Mes jush jetoj”, një përmbledhje me krijimtarinë më të spikatur të poetit të mirënjohur Jorgo Papingji, autor i shumë teksteve të njohura të këngëve të interpretuara në Festalet Kombëtare të Këngës, për 50 vjet me radhë. Grupi Eurosig ndihmoi financiarisht për botimin e këtij libri, me qëllim që i madhi Jorgo Papingji të jetojë gjatë në kulturën dhe historinë tonë, përmes veprave të tij.
- ✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti veprimtarinë për hapjen e sezonit turistik në Tropojë, me pjesëmarrjen e disa personaliteteve. Tashmë turistë shqiptarë dhe të huaj do të gjejnë të gjitha komoditetet për të shijuar mrekullitë e Tropojës.
- ✦ Universiteti European i Tiranës organizoi më 30 maj Panairin e Karrierës, ku morën pjesë edhe Eurosig dhe Insig. Të shumtë ishin studentët e interesuar për industrinë e sigurimeve, të cilët aplikuan për punësim dhe



internship në kompanitë e Grupit. Gjithnjë jemi në mbështetje të të rinjve që i drejtohen tregut të punës.

- ✦ Për disa ditë u mbajt në Tiranë edicioni i 15-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit. Organizimi i ngjarjes më të rëndësishme botërore për nxitjen e kulturës së transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike iu besua, për herë të parë, Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në Shqipëri. Nisur nga kjo, Grupi Eurosig vendosi të mbështesë financiarisht mbajtjen e kësaj Konference, ku morën pjesë rreth 200 përfaqësues të shteteve/juridiksioneve anëtare nga të gjitha kontinentet dhe nga organizata ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës, UNESCO, Banka Botërore, nga bota akademike, shoqëria civile apo media vendase dhe e huaj.
- ✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti një nga ekipet shqiptare për të garuar në edicionin e 20-të të Rally Albania, që zgjati rreth 8 ditë. Duke u nisur nga Tirana dhe duke vijuar në çdo skaj të Shqipërisë, mbi 300 garues, nga 22 vende të ndryshme të botës, krijuan adrenalinë, duke prekur mbi 500 fshatra në itinerarin e vitit 2024. Kjo nuk ishte vetëm garë, por edhe promovim sportiv e zhvillim ekonomik për vendin tonë.
- ✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA përkrahu organizimin e Za Fest, i kthyer tashmë në një festival të mirëfilltë, duke promovuar artistët, vlerat dhe traditën shqiptare. Edhe këtë vit, Za Fest, i mbajtur për 3 ditë radhazi në Kalanë e Shkodrës, krijoi një atmosferë mbresëlënëse përmes artistëve me emër të muzikës shqiptare, por edhe përmes elementëve të rinj të shtuar.



“  
**Promovojmë  
artistët, vlerat dhe  
traditën shqiptare,  
edhe elementëve të  
rinj të shtuar**



- ✦ Largimi fizikisht nga jeta i shkrimtarit të madh Ismail Kadare ishte një humbje e madhe për familjarët, miqtë dhe për të gjithë shqiptarët. Por veprat që ai la pas, do ta mbajnë lart emrin e tij për shekuj me radhë. Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, së bashku me bashkëshorten e shkrimtarit, Znj. Helena Kadare, organizuan një drekë përkujtimore për familjarët dhe miqtë e tij pranë Bar Restorant “Piazza”, duke kujtuar Kadarenë dhe veprat e tij. Në këtë drekë mbajtën fjalën Znj. Kadare, Z. Blendi Fevziu, Z. Bujar Hudhri dhe Z. Morinaj, i cili, ndër të tjera, nxori nga arkiva veprën e parë të Ismail Kadaresë “Frymëzimet Djaloshare”, e botuar në vitin 1954.





✦ Ekspozita “Reflektim mbi pasqyrimin vibrues të artit shqiptar në shekullin XX”, ku u ekspozua një përmbledhje e veprave të mbi 80 artistëve, hapi dyert për çdo artëdashës, falë mbështetjes së Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA.

✦ Trepça dhe Eurosig, së bashku edhe në sezonin e ri. Eurosig si ofrues i produkteve dhe shërbimeve inovatore të sigurimeve në tregun kosovar, ka vazhduar bashkëpunimin me Klubin e Basketbollit Trepça për sezonin e ri 2024/2025. Presidenti i klubit, Z. Vullnet Sefaja, dhe pronari i Eurosig, Z. Kadri Morinaj, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila thëllon edhe më shumë bashkëpunimin në mes nesh. Eurosig ndihet krenar si sponsor i Ekipit të Basketbollit Trepça, kampionë të Kosovës, që u vizitua edhe nga Kryeministri Albin Kurti.

✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA mbërriti në Klos për të festuar së bashku me matjanët. Grupi Eurosig ndihmoi financiarisht Bashkinë Klos në organizimin e Panairit “Vjeshtë në Klos” dhe të “Folk Fest Klos, Edicioni 5”.

✦ Me rastin e 65-vjetorit të krijimit të Radio Kukësit, Grupi Eurosig ndihmoi në organizimin e aktiviteteve në qytetin e Kukësit. Shumë kujtime erdhën në sytë e publikut në Pallatin e Kulturës “Hasan Prishtina”, duke u pasuar me një koncert me këngë e valle. Shumë personalitete të pranishëm, përshëndetën këtë përvjetor dhe Grupin Eurosig për mbështetjen. Gjithashtu, në këtë ceremoni kremtuese u festua edhe 5-vjetori i RTSH Kukës.

✦ Grupi Eurosig-Insig zhvilloi trajnime për punonjësit me ekspertin e Institutit Shqiptar të Gjuhës së Trupit, Z. Ksenofon Ilija, për 3 ditë radhazi në ambientet e kompanive. Tema e shtjelluar në këto trajnime ishte rëndësia e madhe që ka Gjuha e Trupit në komunikimin jo-verbal në marrëdhëniet ndërpersonale për punonjësit, si dhe marrëdhëniet me publikun.

“  
Eurosig mbështeti  
Bashkinë Klos  
në organizimin e  
Panairëve dhe “Folk  
Fest Klos, Edicioni 5”



“  
Presidenti i Grupit  
Eurosig, Z. Kadri Morinaj,  
referon në konferencën  
“Transformimi i  
Ekonomisë dhe Biznesit  
përmes Inovacionit”

✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti Fakultetin e Ekonomisë (FEUT) për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare ICEBIT 2024 me temë: “Transformimi i Ekonomisë dhe Biznesit përmes Inovacionit dhe Zgjidhjeve Digjitale”. Në këtë konferencë mbajti fjalën edhe Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, i cili, ndër të tjera, theksoi: “Pavarësisht se digjitalizimi i bizneseve ka nisur të ecë vitet e fundit, ende kemi nevojë që ta thellojmë atë, veçanërisht në industrinë e sigurimeve dhe financiare duke përfshirë edhe implementimin e Inteligjencës Artificiale. Kështu klienti do të gjejë zgjidhje në kohë rekord, njëkohësisht do të kursenim energji dhe burimet tona njerëzore. Mbështetja për Fakultetin Ekonomik do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi ky fakultet është “fabrika” e burimeve njerëzore në industrinë financiare.”

✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA Bank u vjen në ndihmë 370 familjeve të prekura nga përmytjet në Vlorë. Me iniciativë të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, Z. Ermal Dredha, përfaqësues të Grupit vizituan familje të prekura nga përmytjet, duke u shpërndarë atyre pajisje të ndryshme shtëpiake. Kryetari i Bashkisë shprehu mirënjohjen për gatishmërinë e Grupit Eurosig që këto familje t’u rikthehen jetës normale sa më shpejt.

✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti Bienalen Ndërkombëtare të Artit Bashkëkohor në Durrës. Bienalja Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor ka si qëllim shpërfaqjen dhe spikatjen e vlerave artistike të së tashmes tonë nëpërmjet qasjes konceptuale dhe filozofike të artistëve bashkëkohor mbi temën: “Inteligjenca artificiale: e ardhmja hibride.” Një ndër ndalesat më të vizituara të Bienales është Pavioni Kom-





**Eurosig dhuroi  
10,000 euro për  
dy familjet e  
dëshmorëve të rënë  
në Mitrovicën e Veriut,  
Afrim Bunjaku dhe  
Enver Zymberi**

bëtar i Suedisë dhe Pavioni Kombëtar i Italisë, në mjediset e Vilës së Mbretit Zogu I.

- Me rastin e Vitit të Ri 2025, me iniciativën e gazetarit Osman Stafa dhe me mbështetjen financiare të Z. Kadri Morinaj, Grupi Eurosig-Insig-UBA shpërndau dhurata për dhjetëra fëmijë të shtruar në Pediatri të Spitalit të Elbasanit.
- Me rastin e festave të fundvitit dhe nën kujdesin Presidentit të Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, Shoqëria Eurosig Kosovë bëri të mundur dhurimin e 10,000 eurove për dy familjet e dëshmorëve të rënë në Mitrovicën e Veriut, Afrim Bunjaku dhe Enver Zymberi. Kjo iniciativë e Z. Morinaj është një pjesë e angazhimit të Eurosig Kosovë për t'u qëndruar pranë familjeve të dëshmorëve dhe për të siguruar se kujtimi për ata që dhanë jetën për lirinë dhe integritetin e vendit tonë do të mbetet i përjetshëm. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë pranë familjeve të dëshmorëve, duke ofruar mbështetje financiare dhe shoqërore.
- Puka ishte destinacioni i Grupit Eurosig-Insig-UBA për t'u ardhur në ndihmë dhjetëra familjeve në nevojë. Ne menduam që edhe fëmijët e Pukës të festojnë më së miri ndërrimin e viteve, për këtë arsye u dërguam në shtëpitë e tyre pako ushqimore. Ju urojmë të gjithë shqiptarëve shëndet e begati gjatë vitit 2025.

**Veprimtari në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe promovimit të vlerave të Eurosig u zhvilluan edhe në periudhën e parë të vitit 2025, ndër të cilat, evidentojmë:**

- Me iniciativën e Z. Kadri Morinaj dhe në bashkëpunim me shoqatat në Angli, Grupi Eurosig-Insig-UBA mundësoi dhurimin e rreth 1000 librave Abetare dhe Gjuhë Shqipe për bashkëatdhetarët tanë në Mbretërinë e Bashkuar. Me këtë rast, në shenjë falenderimi, deputeti Lavdrim Krashi i dorëzoi Z. Morinaj "Çertifikatë Mirënjohje" të akorduar nga Shoqata Ardhmëria për kontributin e dhënë, duke mundësuar mësimin e gjuhës dhe ruajtjes së traditave shqiptare për fëmijët në Diasporë. Në këtë veprimtari, Z. Morinaj theksoi: "Jam shumë krenar për qindra fëmijë shqiptarë që po mësojnë gjuhën shqipe në Angli. Kemi kontribuar dhe do të kontribuojmë gjithmonë që gjuha shqipe të flitet, të shkruhet e të lexohet nga të gjithë fëmijët shqiptarë kudo në botë." Gjithashtu, Z. Morinaj u shpreh i gatshëm që, në një kohë të shpejtë, të pajisë me libra të gjithë fëmijët shqiptarë në Britani.
- Në muajin e shenjtë të Ramazanit, Grupi Eurosig-Insig-UBA organizoi një iftar, duke bërë bashkë personalitete të shquar, ambasadorë, gazetarë, bashkëpunëtorë dhe partnerë te Bar Restorant "Piazza". Ky iftar u shtrua me iniciativën e Presidentit të Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, i cili falenderoi të ftuarit për përkushtimin e sakrificën e tyre ndaj Zotit dhe vetvetes. Tashmë, ky organizim është kthyer në traditë në këtë muaj agjërimit jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytete të tjera, duke shërbyer si një mundësi për të ndarë vlerat e mirësisë, paqes dhe solidaritetit. Zoti ua pranoftë sakrificën të gjithë agjëruesve.



**Eurosig dhuroi  
rreth 1,000 libra  
Abetare dhe Gjuhë  
Shqipe për fëmijët  
shqiptarë në Britani**





- ✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA shpërndau për besimtarët e Kukësit qindra pako ushqimore për Natën e Kadrit, në muajin e Shenjtë të Ramazanit. Nata e Kadrit është dita më e shenjtë e Muajit të Ramazanit, natë në të cilën ka lindur edhe Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj. Ai është një besimtar mysliman dhe ka mbështetur financiarisht jo vetëm Xhami, por edhe Kisha në mbarë vendin. Nisur nga kjo, Z. Morinaj mori iniciativën për të përgatitur qindra pako ushqimore, që u shpërndanë në shumë fshatra; një pjesë e mirë e tyre iu dorëzuan Myftiut të Kukësit, Z. Emirjon Vathaj, i cili mori përsipër shpërndarjen tek besimtarët me të ardhura jo të mira. Gjithashtu, Grupi Eurosig ndihmoi edhe shoqatën e të verbërve në Kukës, duke bërë të mundur që edhe kjo kategori të merrte pako ushqimore me rastin e Muajit të Ramazanit. I gjithë muaji i Ramazanit ka qenë në fokus të Presidentit të Grupit Eurosig, Z. Morinaj, duke organizuar çdo ditë iftar për besimtarët myslimanë në shumë qytete e fshatra të Shqipërisë.
- ✦ Grupi Eurosig mbështet të ardhmen e biznesit. Jemi krenarë që u bëmë pjesë e “AI Business Summit” në kryeqytet, një samit që bashkon mendjet më të ndritura të sipërmarrjes dhe inovacionit. Përmes kësaj mbështetjeje financiare, Grupi Eurosig-Insig-UBA synon të fuqizojë rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zhvillimin e ideve të reja që kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të ekonomisë sonë. Besojmë në fuqinë e komunitetit dhe forcën që krijohet kur njerëzit me vizion bashkohen.
- ✦ Grupi Eurosig-Insig-UBA u bë pjesë e Panairit të Punës pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Grupi Eurosig u bë pjesë e këtij Panairi me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të Universitetit të Shkodrës. Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri

Morinaj, mbajti një fjalim inspirues për studentët e këtij universiteti, duke i ftuar ata të aplikojnë për punësim në kompanitë e Grupit Eurosig. Gjithashtu, i inkurajoi ata të jenë kërkues nga vetja, pasi vetëm me punë dhe përkushtim do të arrijnë rezultate në jetë. Z. Morinaj ftoi drejtuesit e Universitetit “Luigj Gurakuqi” të krijojnë së bashku një shkollë verore, me qëllim që të njihen me praktikën e punës në industrinë financiare. U tregua interes i lartë nga studentët që aplikuan për t’u bërë pjesë e Grupit tonë, si kandidatë të mundshëm për punësim, apo për praktika mësimore. Grupi Eurosig-Insig-UBA gjithnjë i ka hapur dyert për studentët ambiciozë për të punuar dhe për t’u rritur profesionalisht.

- ✦ Nderim i veçantë ndërkombëtar për Z. Kadri Morinaj, President i Grupit Eurosig-Insig-UBA! Z. Kadri Morinaj, President i Grupit Eurosig, është dekoruar me Medaljen “Zemra Qelibar” nga Ministri i Jashtëm i Ukrainës, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm humanitar dhe solidaritetin e treguar ndaj popullit ukrainas në një kohë të vështirë. Kjo medalje ka një vlerë me peshë dhe domethënie të veçantë për popullin ukrainas. Gjithashtu, në shenjë falenderimi nga Ambasada e Ukrainës në Tiranë, Zotit Morinaj iu dhurua këmisha me vlera kombëtare ukrainase e quajtur “Vyshyvanka”. Ky vlerësim i Ministrit të Jashtëm të Ukrainës Z. Andriy Sybiha për Z. Morinaj është dëshmi e angazhimit të tij të palodhur për ndihmën ndaj komuniteteve në nevojë, jo vetëm në Shqipëri, por edhe përtej kufijve tanë. Me këtë rast, Ambasadori Shukrov organizoi edhe një ekspozitë pikturash në ambientet e Ambasadës së Ukrainës, ku spikatej një ndërthurje e pikturave të heronjve kombëtarë shqiptarë dhe atyre ukrainas. Jemi krenarë që në krye të Eurosig qëndron një lider që promovon vlerat humane, përgjegjësinë sociale dhe ndihmën konkrete aty ku njerëzimi ka më shumë nevojë.






## PJESËMARRJET E EUROSIG SH.A. NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TË TJERA

Eurosig sh.a zotëron 100% të kapitalit të shoqërive Insig sh.a. dhe Insig Jetë sh.a., në Republikën e Shqipërisë, dhe të Eurosig sh.a, në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, Eurosig sh.a zotëron 99.53% të kapitalit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (UBA) dhe 49% të kapitalit të Eurosig-Invest.

## LISTA E AKSIONARËVE TË EUROSIG ME PJESËMARRJE INFLUENCUESE TË KAPITALIT



## LISTA E ADMINISTRATORËVE TË EUROSIG

**Administrator është z. Xhevdet KOPANI.**

Ai nuk është pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë.

## OPINION I SHKURTUAR MBI AUDITIMIN E BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm për vitin 2024 në shoqërinë e sigurimeve "Eurosig sh.a." është zhvilluar në përputhje me "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm" dhe "Manualin e Auditimit të Brendshëm", si dhe në zbatim të Ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", të Rregullores së AMF nr. 153, datë 23. 12. 2014, "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit", të Rregullores nr. 7, datë 30. 01. 2015, "Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Shoqërinë Eurosig sh.a." dhe të "Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024" të Shoqërisë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit 2024, ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Eurosig. Pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit dhe Menaxhimit të Rrezikut, Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm 2024 u shqyrtua dhe miratua dhe nga Këshilli Mbikëqyrës. Raporti u është shpërndarë për njohje dhe zbatim të gjitha strukturave të Eurosig.



**Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës**



**Departamenti i Marrjes në Sigurim** – Gjatë vitit 2024 kompania ka pasur rritje të primeve në masën rreth 7.61%. Raporti sigurime të detyrueshme/sigurime vullnetare është 80% me 20%, kundrejt objektivit të vendosur 77% me 23%. Nga analiza e këtij treguesi për vitet e fundit vihet re një trend në rënie i tij, pavarësisht objektivit të kompanisë dhe fokusit në rritjen e shitjeve të produkteve vullnetare. Nëse analizojmë sipas njësive të shitjes rezulton se kontributin më të madh në shitje e kanë dhënë njësitë e Tiranës dhe Durrësi. Pavarësisht performancës së mirë të disa njësive, objektivi i vendosur lidhur me produktet vullnetare nuk është realizuar pothuajse në asnjë njësi.

Ngakontrolli i komisioneve/zbritjeve rezulton se gjatë vitit 2024 përgjithësisht është ruajtur i njëjti nivel komisionesh si vitin e mëparshëm ose dhe ka rënë, ndërsa niveli i shitjeve është rritur. Po të analizojmë treguesin e shitjeve rezulton se rënia e komisioneve nuk ka pasur impakt negativ në nivelin e shitjeve në pothuajse asnjë njësi shitjeje të kompanisë, gjë që tregon se niveli i shpenzimeve të marrjes në sigurim duhet të monitorohet, në mënyrë që të reduktohen kostot e panevojshme të Shoqërisë.

Është rritur kontrolli i ushtruar nga strukturat e marrjes në sigurim në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Administrimit të Shitjeve dhe, si rezultat i kësaj, ka pasur një përmirësim të dukshëm lidhur me: zbatimin e procedurave të marrjes në sigurim, kushtet e kontratave të sigurimit etj. Përgjithësisht, është vlerësuar saktë rreziku i klientëve dhe përcaktimi i primeve është bërë në përputhje me rrezikun. Janë organizuar trajnime, si dhe është rritur bashkëpunimi me strukturat vendore në funksion të identifikimit të mundësive të zgjerimit të tregut.



**Është vlerësuar saktë rreziku i klientëve dhe përcaktimi i primeve është në përputhje me rrezikun**



**Drejtori të tjera të Shoqërisë** – Gjatë vitit 2024, janë hartuar dhe miratuar një sërë rregulloresh dhe urdhërash me qëllim që të arrihet përputhshmëria e plotë me bazën ligjore dhe në fokus ka qenë siguria e informacionit dhe vazhdimësia e biznesit. Janë rishikuar dhe përmirësuar procedurat për raportimin financiar, funksionin e pajtueshmërisë, transaksionet me palët e lidhura, mbrojtjen e të dhënave personale etj. Janë bërë përmirësime në Sistemin e Brendshëm në funksion të përshtatjes së tij me kërkesat e palëve të treta dhe strukturave të Shoqërisë, si dhe ofrimit të një shërbimi më të mirë për klientët. Është përmirësuar moduli i dëmeve dhe është vënë në funksion të plotë për gjenerimin e raporteve nga sistemi.

**Strukturat e Trajtimit të Dëmeve** kanë funksionuar mbi bazën e rregulloreve, udhëzimeve, urdhërave të brendshëm të Shoqërisë. Gjatë vitit 2024, është arritur që, sipas udhëzimeve nga Drejtoria e Përgjithshme, të trajtohen e të dëmshpërblehen klientët brenda afateve të përcaktuara. Janë trajtuar me prioritet rastet e klientëve, të cilët nuk kanë qenë dakord me dëmshpërblimet, të cilat janë diskutuar në komisionet e posaçme me qëllim që t'u shërbehet sa më mirë klientëve dhe të kryhet vlerësim sa më i drejtë. Përgjithësisht, praktikat janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe gjatë trajtimit rezulton se janë zbatuar kushtet e kontratave të sigurimit. Është rritur numri i praktikave të zgjidhura me marrëveshje, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e treguesit të rezervës së dëmeve në proces gjyqësor, si dhe respektimin e afateve kohore të trajtimit të praktikave.

**Statistika** – Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policave janë të pasqyruara saktë në Sistemin e Brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Të dhënat lidhur me praktikat e dëmeve janë pasqyruar saktë në databazën e dëmeve, si dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Janë respektuar afatet e dërgimit të evidencave ndërmjet strukturave, si dhe afatet e dërgimit të tyre në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

**Mbrojtja nga Rreziku** – Veprimtaria e strukturave të Shoqërisë Eurosig sh.a. bazohet në *“Strategjinë për Menaxhimin e Rrezikut”*, në të cilën janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e



menaxhimit të rrezikut. Në këtë strategji dhe në *“Politikat dhe Procedurat për Menaxhimin e Rrezikut”* janë përcaktuar në mënyrë të plotë procesi i menaxhimit të rrezikut, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave të Shoqërisë për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve. Në procesin e vlerësimit të rreziqeve janë përfshirë të gjitha strukturat e Shoqërisë, të cilat raportojnë në strukturën e menaxhimit të rrezikut çdo 6 muaj. Përfshirja e vet strukturave në këtë proces ka pasur impakt pozitiv në identifikimin e rreziqeve në kohë dhe marrjen e masave për reduktimin apo eliminimin e tyre.

Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut ka hartuar *“Raportin e Vetëvlerësimit të Rrezikut dhe Aftësisë Pagueze”*, në të cilin janë identifikuar dhe vlerësuar nivelet e rreziqeve, ndaj të cilëve është e ekspozuar Shoqëria, si dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme për menaxhimin e tyre, me qëllim reduktimin e rreziqeve të identifikuara, si dhe parandalimin e ekspozimit ndaj rreziqeve në të ardhmen.

Në përgjithësi, ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Ka pasur një përmirësim të procedurave të kontrollit të ushtruar nga Departamenti i Marrjes në Sigurim lidhur me zbatueshmërinë e procedurave të marrjes në sigurim, administrimin e policave dhe, si rezultat i kësaj, problematikat janë evidentuar përgjithësisht në kohë dhe janë marrë masa për zgjidhjen e tyre. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e rreziqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.



**Ka qenë eficient sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara**



**Eurosig ka implementuar një sistem të plotë për menaxhimin e riskut të shpërndarë në të gjitha nivelet**

## MONITORIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I RISKUT QË NDËRMERR EUROSIG

Eurosig ka implementuar një sistem të plotë për menaxhimin e riskut të shpërndarë në të gjitha nivelet, për të identifikuar, vlerësuar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe raportuar në vijimësi risqet me të cilat është përballur ose mund të përballlet Shoqëria, sipas linjave të biznesit ose në tërësi. Strukturat e Eurosig zbatojnë elementët e këtij sistemi, duke u bazuar në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, si dhe në natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së Shoqërisë. Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të Eurosig, në drejtim të pranimin dhe menaxhimit të riskut, organet qeverisëse kanë nxjerrë një paketë aktesh të brendshme, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullatore, ku veçojmë: Strategjinë për Menaxhimin e Riskut, Politikat dhe Procedurat për Menaxhimin e Rrezikut etj. Organet drejtuese, menaxhmenti dhe çdo punonjës ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij, në lidhje me riskun dhe menaxhimin e tij.

Sistemi i menaxhimit të riskut në Eurosig bazohet në mirëfunksionimin e organeve qeverisëse dhe të tre linjave të mbrojtjes: funksionet Operacionale – linja e parë e mbrojtjes, që kanë përgjegjësinë bazë për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë; funksionet e Menaxhimit të Rrezikut, të Aktuarit të Autorizuar dhe të Pajtuashmërisë – linja e dytë e mbrojtjes; funksioni i Auditimit të Brendshëm – linja e tretë e mbrojtjes.



Në Strategjinë për Menaxhimin e Riskut në Eurosig janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut, procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë për menaxhimin e riskut, si dhe rrugët që do ndiqen për zbatimin e kësaj strategjie. Strukturat përgjegjëse të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të riskut janë Komiteti i Auditimit & Menaxhimit të Riskut, Njësia e Auditimit, Komiteti i Pajtueshmërisë; Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Komiteti për Sigurinë Kibernetike dhe Vazhdimësinë e Biznesit, Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit dhe Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, komunikon me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit & Menaxhimit të Riskut në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj riskut dhe masat që duhen marrë për menaxhimin e tyre, vlerësimin e ndryshimit në profilin e riskut, vlerësimin e ngjarjeve të riskut, si dhe përcaktimin e veprimeve të përshtatshme për ndreqje të situatës.

Eurosig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në pajtueshmëri me kërkesat e AMF-së, të përcaktuara në Manualin e Mbikëqyrjes me Bazë Rrezikun dhe akte të tjera rregullatore. Drejtoria për Menaxhimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore, çdo vit identifikojnë risqet ndaj të cilëve është e ekspozuar veprimtaria e Eurosig dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave vjetore.

Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në Eurosig u finalizua me:

- ♦ Raportin e Vetëvlerësimit të Rrezikut dhe Aftësisë Paguese për vitin 2024;
- ♦ regjistrat e rreziqeve sipas rreziqeve thelbësorë dhe sipas strukturave raportuese;
- ♦ vlerësimin e funksioneve në raport me menaxhimin e rrezikut;



- ♦ Matricën e Rreziqeve Thelbësore për vitin 2024;
- ♦ Analizën e Testeve të Paralajmërimit të Hershëm, sipas metodologjisë së AMF-së; që u janë shpërndarë autoriteteve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale.

Gjithashtu, sipas përcaktimeve në aktet rregullatore, u hartua edhe Raporti “Mbi Vlerësimin e Rreziqeve në Eurosig për vitin 2024”, i cili është dërguar në AMF.

Për vitin 2024, nga analiza e të gjitha rreziqeve të identifikuar, analizuar dhe vlerësuar, rezulton:

- ♦ Rreziku i Kreditit, Rreziku i Tregut, Rreziku i Sigurimit, Rreziku Operacional (Rreziku i Trajtimit të Dëmeve dhe Rreziku i Mashtrimit), Rreziku i Likuiditetit, Rreziku Ligjor dhe Rregullator dhe Rreziku Strategjik klasifikohen në nivelin i ulët. Drejtimi i këtyre rreziqeve për vitin 2025 vlerësohet i qëndrueshëm.
- ♦ Rreziku i Teknologjisë së Informacionit (i trajtuar të Rreziku Operacional) klasifikohet në nivelin mesatar dhe drejtimi i tij i qëndrueshëm.
- ♦ Nga analiza e vlerave paraprake të Testeve të Paralajmërimit të Hershëm rezulton: Norma e Aftësisë Paguese është 822 pp mbi pragun minimal të kërkuar, Norma e Kapitalit Minimal të Kërkuar është 1082 pp mbi pragun minimal të kërkuar, Marzhi i Aftësisë Paguese është 548 pp mbi pragun minimal të kërkuar. Për rrjedhojë, Aftësia Paguese e Eurosig më 31 dhjetor 2024 dhe treguesit e tjerë të shëndetit financiar janë brenda kërkesave rregullatore.
- ♦ Cilësia e Menaxhimit e fortë jep garanci për menaxhimin me efektivitet dhe zbutjen e rreziqeve të qenësishme të nivelit mesatar ose të lartë, ndaj të cilëve ekspozohet Eurosig.

Autoritetet qeverisëse dhe menaxheriale të shoqërisë janë të angazhuara për ndjekjen me prioritet të çështjeve të evidentuara për secilin rrezik të qenësishëm, veçanërisht për menaxhimin me efektivitet të rreziqeve të identifikuar si kërcënim për realizimin e objektivave të shoqërisë.



TREGUESIT E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT  
TË LIKUIDITETIT DHE TË AKTIVEVE NË MBULIM  
TË PROVIGJONEVE TEKNIKE

TREGUESI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT, MË 31. 12. 2024.

| Nr.  | Emërtimi                                                                                     | Vlera në lekë |
|------|----------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| I    | Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II).                                      | 7,277,398,622 |
| II   | Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç).          | —             |
| III  | Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç).                           | —             |
| IV   | Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V). | 1,777,239,776 |
| V    | Aktivet jolikuide (V.a deri V.g).                                                            | 1,766,459,776 |
| V.h. | Elemente të tjerë të zbritshëm, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje (V.-h-1 deri V.h-10).    | 1,485,744,270 |
| VI   | Kapitali (Aftësia Paguese).                                                                  | 5,500,158,846 |
| VII  | Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014.          | 450,027,372   |
| XIII | Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014.                                     | 370,000,000   |
| IX   | Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014.        | 675,041,058   |
| X    | Mbi (+)/nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë Paguese (VI-IX).                               | 4,825,117,788 |
| XI   | Mjaftueshmëria e kapitalit.                                                                  | I mjaftueshëm |

TREGUESI I LIKUIDITETIT

Treguesi i Raportit të Likuiditetit raportohet periodikisht në AMF, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore. Shoqëria Eurosig është likuide dhe zotëron normë shumë të mirë likuiditeti pasi rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar nenit 6, pika 1, të Rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit”, rezulton më i lartë ose i barabartë me 1.

TREGUESI I AKTIVEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE  
TEKNIKE (PT), MË 31. 12. 2023

| Nr.  | Emërtimi                                                                                                                                           | Vlera e lejuar në mbulim të PT (në lekë) |
|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|
| I    | Aktivet e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14.                               | 3,495,565,144                            |
| II   | Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit. | —                                        |
| III  | Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015, neni 4.                                                                   | 930,411,950                              |
| IV   | Totali i Investimeve (I+II+III).                                                                                                                   | 4,425,977,094                            |
| V    | Totali i Investimeve të Lejuara (Totali i “Vlera në fakt” zbritur “Investime mbi limitet e lejuara”).                                              | 4,237,230,388                            |
| VI   | Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5).                                                                        | 3,804,337,952                            |
| VII  | Tepriçë (+) /Mungesë (-) (V-VI).                                                                                                                   | 432,892,436                              |
| VIII | Mbulimi në % (V/VI)                                                                                                                                | 111.38%                                  |



# OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

## Objektivat strategjike

- 1) Rritja me 15%, krahasuar me vitin 2024, e volumit të primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të aftësisë paguese, të performancës ekonomike, të rezervave, si dhe përsosur sistemin e menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm.
- 2) Në fund të vitit 2025, raporti i volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar me volumin e primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm të jetë në masën 23% me 77%.
- 3) Shpenzimet për vitin 2025 të jenë jo më shumë se 85% e të ardhurave.
- 4) Vlerësim të drejtë dhe pagesë të shpejtë të dëmeve të ndodhura, si dhe rritje deri në 37% të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumin e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2025.
- 5) Rritja e kapaciteteve për sigurinë e informacionit; kryerja e testimeve për Rimëkëmbjen nga Fatkeqësitë dhe Planin e Vazhdimësisë së Biznesit.

## Objektivat specifike

- 1) Nëpërmjet zhvillimit dhe drejtpeshimit të roleve të menaxhimit të performancës, të administrimit, të sipërmarrjes dhe të integritetit të sigurojmë që shoqëria Eurosig të jetë efektive, efiçente, proaktive dhe organike.
- 2) Zbatimi i proceseve qeverisëse të institucionalizuara, nxitja e mundësive të reja dhe menaxhimi proaktiv i ndryshimeve në tregun e sigurimeve, duke ruajtur vlerat themelore dhe avantazhin e Eurosig.
- 3) Menaxhimi i kujdesshëm i shpenzimeve, me objektiv rritjen e fitimit, duke siguruar një aftësi paguese të qëndrueshme, si dhe aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike.
- 4) Forcimi i auditimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.
- 5) Segmentimi i klientëve, duke u përqendruar fort tek produktet vullnetare, nëpërmjet burimeve njerëzore me formimin e duhur profesional, kombinuar me politika efektive marketingu.
- 6) Zbatimi rigoroz i politikave dhe procedurave standarde për marrjen në sigurim dhe risigurimin, me bazë riskun, duke synuar uljen e produkteve me humbje teknike.
- 7) Rishikimi i termave të marrëveshjeve të risigurimit, në lidhje me mjaftueshmërinë e mbulimit, duke reflektuar ndikimet e faktorëve të jashtëm dhe çështjet e identifikuar nga trajtimi periodik i dëmeve.
- 8) Konsolidimi i bashkëpunimit të strukturave të Trajtimit të Dëmeve me

strukturat qendrore dhe vendore, përditësimi i njohurive mbi legjislacionin dhe teknologjinë bashkëkohore, me qëllim vlerësimin e drejtë dhe pagesën në kohë të dëmit.

- 9) Informimi i vazhdueshëm i organeve qeverisëse të shoqërisë për ndryshimet ligjore dhe rregullatore, identifikimi i detyrimeve përkatëse për realizimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator.
- 10) Përshtatja e plotë e rregullave dhe kushteve të shoqërisë me kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore.
- 11) Sigurimi i pajtueshmërisë me përcaktimet ligjore dhe rregullatore, si dhe me standardet ISO 27001, GDPR etj. për të mbrojtur të dhënat e organizatës dhe të klientëve.
- 12) Përmirësimi i infrastrukturës së sigurisë për të identifikuar dhe parandaluar sulmet kibernetike; identifikimi dhe mbrojtja e të gjitha aseteve kritike të informacionit kundër kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme.
- 13) Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve të sigurisë për të reduktuar ndikimet e mundshme; përgatitja dhe zbatimi i planeve për përgjigje ndaj incidenteve.
- 14) Krijimi i një qendre operationale të sigurisë (SOC) për monitorimin e rrjetit dhe reagimin ndaj incidenteve në kohë reale.
- 15) Shfrytëzimi i të gjitha kapaciteteve të programit informatik e-Insure nga strukturat qendrore dhe vendore të Eurosig, duke bërë dhe zhvillimet dhe përmirësimet e nevojshme, sipas çështjeve të evidentuara nga menaxhmenti.
- 16) Përmirësimi i standardeve dhe cilësisë së punës të punonjësve, nëpërmjet përsosjes së politikave të rekrutimit, trajnimeve periodike dhe shpërbimit të drejtë të mbështetur në performancën e tyre.
- 17) Pjesëmarrja aktive në veprimtari që kontribuojnë në qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale.



**Ka qenë efiçent sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara**





# OPINIONI I SHOQËRISË AUDITUESE DHE PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA SIPAS SNRF

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare  
Individuale

**Shoqëria EUROSIG Sh.a**

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024



Grant Thornton Sh.p.k  
Rr. "Sami Frashëri",  
Kompleksi T.I.D, Shk. B, Floor 1  
1001 Tirana  
Albania

T +355 44 525 880  
E [contact@al.gt.com](mailto:contact@al.gt.com)

## Raporti i Audituesit të Pavarur

**Për Aksionerët dhe Drejtimin e Shoqërisë Eurosig Sh.a**

*Opinion me rezervë*

*Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të shoqërisë Eurosig sha ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese. Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në seksion e raportit tonë Bazat për Opinionin me Rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

*Baza për Opinionin me Rezervë*

Siç është shpjeguar në shënimin 25 – Kapitali Aksioner - të pasqyrave financiare individuale, Shoqëria ka realizuar një rritje të kapitalit aksionar përmes një kontributi në natyrë, i cili përbëhet nga dy prona të ndodhura në Tiranë, Shqipëri, të vlerësuara në total me 267,199 mijë lek. Bazuar në procedurat tona të auditimit dhe analizimit të raportit të vlerësuesit, ne nuk mund të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e drejtë të ketyre dy aktiveve afatgjata materiale.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit



#### *Çështje për t'u theksuar*

- Ne tërheqim vëmendjen te Shënimi 9 dhe 36 i pasqyrave financiare individuale, i cili shpjegon transaksionin e nënqirasë financiare me Bankën UBA Sh.a. Më datë 10 dhjetor 2024, Shoqëria ka lidhur një marrëveshje nënqiraje financiare për të njëjtën hapësirë të marrë me qira nga Insig Sh.a, duke njohur si rezultat të këtij transaksioni një fitim prej 507,483 mije lekë në pasqyrën e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024. Ky transaksion ka ndikuar ndjeshëm në rezultatet financiare të Shoqërisë për periudhën raportuese. Vlerësimi i këtij transaksioni dhe trajtimi kontabël i tij është realizuar në përputhje me IFRS 16 – Leases. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.
- Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.4 të pasqyrave financiare individuale në të cilën paraqitet informacion mbi vendimin numër 80-2019-274 datë 01.02.2019 të marrë nga Gjykata Administrative e Shkalles së parë Tirane e cila ka pranuar padinë e Shoqërisë ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 162 datë 30.07.2018 të Bordit të AMF-së dhe masat e marra sipas atij vendimi, si edhe padinë për detyrimin ndaj AMF-së për njohjen e investimit të kryer në blerjen e aksioneve në shoqëritë e kontrolluara, si aktive në mbulim të provizioneve teknike dhe aftësisë paguese Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2254 (86-2019-2581) datë 12.07.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke e kthyer atë në titull ekzekutiv, të detyrueshëm për zbatim. Për pasojë, prej 3 mujorit të dytë të vitit 2019 ka përfshirë në përlogaritjet e treguesve rregullatore investimet në shoqëritë e kontrolluara, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e treguesve rregullatorë. AMF ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë për këtë vendim dhe nuk ka zhvillime të tjera lidhur me këtë çështje.
- Shoqëria nuk ka zbatuar IFRS 17 “Kontratat e Sigurimit” sipas kërkesave të raportimit financiar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) për shoqëritë e sigurimit, të cilat kërkojnë zbatimin e këtij standardi për periudhën që fillon pas 1 janar 2023. Ministria e Financave dhe Ekonomisë si autoriteti me i lartë rregullator në industrinë e shoqërive të sigurimit, me ane të urdhërit nr.106, datë 10.05.2023 “Për shtyrjen e afatit të aplikimit të standardit ndërkombëtar të raportimit financiar (SNRF) 17 “kontratat e sigurimit” ka urdhëruar shpalljen e shtyrjes së afatit të aplikimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e Sigurimit”, me datë efektive pas datës 1 janar 2025. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje

#### *Informacione të tjera*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera të marrë në datën e këtij raporti auditimi janë “Aneksë shoqëruese suplementare”, por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit.

Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to. Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Sikurse është paraqitur në anekset suplementare Shoqëria ka llogaritur raportin e “Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike” dhe raportin mbi “Mjaftueshmërinë e Kapitalit. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

#### *Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### *Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm. Marrim një kuptueshmeri të atyre kontroleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojmë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktajnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.



Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

30 prill 2025

Tiranë, Shqipëri



|                                                                |    | Shënime | 31 dhjetor 2024   | 31 dhjetor 2023   |
|----------------------------------------------------------------|----|---------|-------------------|-------------------|
| <b>AKTIVE</b>                                                  |    |         |                   |                   |
| Aktive afat-gjata materiale                                    | 6  |         | 562,666           | 203,235           |
| Aktive afat-gjata jomateriale                                  | 7  |         | 11,622            | 5,654             |
| Te drejta te perdorimit te aseteve                             | 8  |         | 130,098           | 175,360           |
| Aktive nga Investimi neto i Qirase                             | 9  |         | 135,947           | -                 |
| Depozita me afat                                               | 10 |         | 2,733,100         | 1,487,215         |
| Pjesa e risiguruesit ne provigjionet e kontratave te sigurimit | 11 |         | 309,975           | 391,830           |
| Llogari to arketueshme nga sigurimi dhe risigurimi             | 12 |         | 68,325            | 88,361            |
| Kosto to shtyra to marrjes ne sigurim                          | 13 |         | 437,203           | 435,693           |
| Investime ne shoqeri te kontrolluara                           | 14 |         | 8,135,485         | 7,440,485         |
| Investime ne tituj kapitali te shoqerive te tjera              | 15 |         | 10,780            | 10,780            |
| Aktive ne process                                              | 16 |         | 483,705           | 385,345           |
| Aktive afategjata te investimit                                | 17 |         | 656,688           | 700,000           |
| Aktive te tjera                                                | 18 |         | 272,771           | 141,644           |
| Mjete monetare dhe ekuivalente                                 | 19 |         | 32,543            | 9,260             |
| <b>Totali i aktiveve</b>                                       |    |         | <b>13,980,907</b> | <b>11,474,862</b> |
| <b>KAPITALI</b>                                                |    |         |                   |                   |
| Kapitali i nenshkruar                                          | 25 |         | 5,642,850         | 4,515,650         |
| Rezerva rivleresimi                                            |    |         | 154,345           | 154,345           |
| Rezerva të tjera                                               | 26 |         | 10,334            | 10,334            |
| Fitime / Humbje te akumuluar                                   |    |         | 788,639           | (227,305)         |
| Fitimi / Humbja e vitit financiar                              |    |         | 681,231           | 1,015,944         |
| <b>Totali i kapitalit</b>                                      |    |         | <b>7,277,399</b>  | <b>5,468,968</b>  |
| <b>DETYRIMET</b>                                               |    |         |                   |                   |
| Provigjione per kontratat e sigurimit                          | 20 |         | 3,804,338         | 3,526,405         |
| Detyrime to qirase financiare                                  | 21 |         | 283,405           | 174,519           |
| Hua Afategjata                                                 | 22 |         | 660,000           | 660,000           |
| Te ardhura te paperfituara                                     |    |         | 1,031,625         | 415,310           |
| Provizione te tjera                                            |    |         | 29,301            | 29,301            |
| Llogari te pagueshme per sigurimin, risigurimin dhe to tjera   | 23 |         | 766,376           | 1,043,812         |
| Detyrim per Fondi kompesimi                                    | 24 |         | 97,397            | 110,065           |
| Detyrimi per tatimin mbi fitimin                               |    |         | 31,066            | 46,482            |
| <b>Totali i detyrimeve</b>                                     |    |         | <b>6,703,508</b>  | <b>6,005,894</b>  |
| <b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>                       |    |         | <b>13,980,907</b> | <b>11,474,862</b> |

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 4-55 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 28 mars 2025, dhe janë firmosur në emër të tij nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori Departamentit Ekonomik dhe Zv. Drejtor i Përgjithshëm.

Z. Xhevdet Kopani

Drejtori i Përgjithshëm



Znj. Anila Ibraj

Drejtor i Departamentit Ekonomik  
Zv. Drejtor i Përgjithshëm



Shoqëria Eurosig Sh.a

Pasqyra Individuale e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

|                                                                             | Shënime   | Për vitin e<br>mbyllur më 31<br>dhjetor 2024 | Për vitin e<br>mbyllur më 31<br>dhjetor 2023 |
|-----------------------------------------------------------------------------|-----------|----------------------------------------------|----------------------------------------------|
| Primet e shkruara bruto                                                     | 27        | 3,094,289                                    | 2,875,560                                    |
| Primet e ceduara në risigurim                                               | 27        | (157,314)                                    | (161,838)                                    |
| <b>Total të ardhura</b>                                                     | <b>27</b> | <b>2,936,975</b>                             | <b>2,713,722</b>                             |
| Ndryshimi në provigjionin e primeve të pafituara bruto (+/-)                | 27        | (154,744)                                    | (195,437)                                    |
| Ndryshimi në provigjionin e primeve të pafituara, pjesa e risiguresve (+/-) | 27        | (17,163)                                     | 30,484                                       |
| <b>Prime te fituara neto</b>                                                | <b>27</b> | <b>2,765,068</b>                             | <b>2,548,769</b>                             |
| Të ardhura nga tarifat dhe komisionet-neto                                  | 28        | 26,894                                       | 32,901                                       |
| Të ardhura financiare dhe nga investimet                                    | 29        | 638,226                                      | 23,650                                       |
| Shpenzime financiare dhe nga investimet                                     | 29        | (57,667)                                     | (20,413)                                     |
| <b>Të ardhura neto</b>                                                      |           | <b>3,372,521</b>                             | <b>2,584,907</b>                             |
| Dëme dhe përfitime të shlyera                                               |           | (1,170,909)                                  | (800,297)                                    |
| Dëme dhe përfitime të shlyera risiguresi                                    |           | 228,146                                      | 7,643                                        |
| Ndryshimi në provigjionin e dëmeve                                          |           |                                              |                                              |
| Ndryshimi në provigjionin e dëmeve te risigurimit                           |           | (187,881)                                    | (107,834)                                    |
| <b>Dëmet dhe përfitimet e shlyera të polic-mbajtësve, neto</b>              | <b>30</b> | <b>(1,130,644)</b>                           | <b>(900,488)</b>                             |
| Kosto të marrjes në sigurim                                                 | 31        | (715,967)                                    | (653,723)                                    |
| Shpenzime administrative                                                    | 32        | (716,976)                                    | (181,260)                                    |
| Zhvleresim i investimeve                                                    |           | -                                            | 230,000                                      |
| Shpenzime të tjera operative                                                | 33        | (12,894)                                     | (12,513)                                     |
| <b>Totali i shpenzimeve</b>                                                 |           | <b>(1,445,837)</b>                           | <b>(617,496)</b>                             |
| Fitimi/ (humbje) të tjera                                                   | 34        | 32,177                                       | 17,756                                       |
| <b>Fitimi/humbja para tatimit</b>                                           |           | <b>828,217</b>                               | <b>1,084,679</b>                             |
| <b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>                                      | <b>35</b> | <b>(146,986)</b>                             | <b>(68,735)</b>                              |
| Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin                                      |           | (70,864)                                     | (68,735)                                     |
| Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë                                        |           | (76,122)                                     | -                                            |
| <b>Fitimi/humbja e vitit</b>                                                |           | <b>681,231</b>                               | <b>1,015,944</b>                             |
| <b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>                      |           | <b>-</b>                                     | <b>-</b>                                     |
| Diferencat (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale             |           | -                                            | -                                            |
| <b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>           |           | <b>-</b>                                     | <b>-</b>                                     |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>                    |           | <b>681,231</b>                               | <b>1,015,944</b>                             |

Pasqyra Individuale e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-55 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shoqëria Eurosig Sh.a

Pasqyra e Individuale e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

|                                                                                 | Shënime | Për vitin e<br>mbyllur më 31<br>dhjetor 2024 | Për vitin e<br>mbyllur më 31<br>dhjetor 2023 |
|---------------------------------------------------------------------------------|---------|----------------------------------------------|----------------------------------------------|
| <b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>                               |         |                                              |                                              |
| Fitimi para tatimit                                                             |         | 681,231                                      | 1,015,944                                    |
| Axhustime për zërat jo-monetare:                                                |         | -                                            | -                                            |
| Amortizimi i aktiveve afat-gjata                                                |         | 103,509                                      | 73,578                                       |
| Të ardhura financiare dhe nga investimet                                        |         | (130,719)                                    | (22,722)                                     |
| Zhvleresim i llogarive te arketueshme                                           |         | -                                            | -                                            |
| Rritje/ renie e pjesës së risiguresit në provigjionet e kontratave te sigurimit |         | 81,855                                       | (26,897)                                     |
| <b>Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin qarkullues</b>                 |         | <b>735,876</b>                               | <b>1,039,903</b>                             |
| Rënie në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe te tjera te arketueshme       |         | 20,036                                       | 31,279                                       |
| Rënie në koston e shtyrë të marrjes në sigurim                                  |         | (1,510)                                      | (94,669)                                     |
| (Rritje) në aktive te tjera                                                     |         | (131,127)                                    | 30,582                                       |
| Rritje/(rënie) në provigjionet e kontratave të sigurimit                        |         | 277,933                                      | 299,684                                      |
| Renie në llogaritë e pagueshme për sigurimet, risigurimet dhe llogari të tjera  |         | 237,183                                      | 931,261                                      |
| Detyrim per Fondin e kompesimi                                                  |         | (12,668)                                     | (6,689)                                      |
| <b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>                  |         | <b>1,125,723</b>                             | <b>2,231,351</b>                             |
| Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit                                         |         | 86,280                                       | 22,253                                       |
| <b>Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet operative</b>                |         | <b>1,212,003</b>                             | <b>2,253,604</b>                             |
| <b>Aktivitetet investuese</b>                                                   |         |                                              |                                              |
| Shtesa/pakesime të investimeve në shoqëri të kontrolluara                       |         | (695,000)                                    | (2,832,650)                                  |
| Shtesa/pakesime të Aseteve ne proces                                            |         | 601,640                                      | (785,497)                                    |
| Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale                          |         | (1,073,476)                                  | (74,526)                                     |
| Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale                           |         | (5,968)                                      | 56,000                                       |
| Renie/(rritje) ne depozitat me afat                                             |         | (1,115,166)                                  | (977,820)                                    |
| Shtesa e drejta ne perdorim                                                     |         | (136,836)                                    | (143,865)                                    |
| <b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>                    |         | <b>(2,424,806)</b>                           | <b>(4,758,358)</b>                           |
| <b>Aktivitetet financuese</b>                                                   |         |                                              |                                              |
| Rritje renie ne leasing financiar                                               |         | -                                            | -                                            |
| Ndryshim ne qerane financiare                                                   |         | 108,886                                      | 760,175                                      |
| Rritje kapitali                                                                 |         | 1,127,200                                    | 1,750,000                                    |
| Shtesa/ (Shlyerje) për huatë e marra                                            |         | -                                            | -                                            |
| <b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti finances</b>                     |         | <b>1,236,086</b>                             | <b>2,510,175</b>                             |
| Ndryshimi neto i mjeteve monetare                                               |         | 23,283                                       | 5,421                                        |
| Mjetet monetare në fillim të periudhës                                          |         | 9,260                                        | 3,839                                        |
| <b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>                                     |         | <b>32,543</b>                                | <b>9,260</b>                                 |



**Shoqëria Eurosig Sh.a**  
 Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024  
 (Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

|                                                                     | Kapitali aksionar | Rezerva Rivlerësimi | Rezerva të tjera | Fitimet e Pashpërndara | Totali           |
|---------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------|------------------|------------------------|------------------|
| Pozicioni financiar më 1 janar 2023                                 | 2,765,650         | 154,345             | 10,334           | (227,305)              | 2,703,024        |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar                                   | 1,750,000         |                     |                  |                        | 1,750,000        |
| Rritje/renie e rezerves se rivleresimit                             |                   |                     |                  |                        | -                |
| Totali i fitim/humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin |                   |                     |                  | 1,015,944              | 1,015,944        |
| <b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023</b>                       | <b>4,515,650</b>  | <b>154,345</b>      | <b>10,334</b>    | <b>788,639</b>         | <b>5,468,968</b> |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar                                   | 1,127,200         |                     |                  |                        | 1,127,200        |
| Rritje/renie e rezerves se rivleresimit                             |                   | -                   |                  |                        | -                |
| Transferim i fitimeve ne rezerva per investime                      |                   |                     |                  |                        | -                |
| Totali i fitim/humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin |                   |                     |                  | 681,231                | 681,231          |
| <b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024</b>                       | <b>5,642,850</b>  | <b>154,345</b>      | <b>10,334</b>    | <b>1,469,870</b>       | <b>7,277,399</b> |

Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-55 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare





 [eurosig.al](http://eurosig.al)